

Termat e referencës: “Ekspert për krijimin e një Raporti strategjik mbi Integrimin e Aspekteve Socio-Ekonomike në Menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës-PKP”, për AdZM Korçë, aktiviteti 3.1

1. Hyrje

Parku Kombëtar i Prespës-PKP është një zonë me rëndësi të lartë ekologjike dhe socio-ekonomike, pjesë e Rajonit të Biosferës së Prespës. Ekosistemet e tij të pasura dhe komunitetet lokale janë të ndërlidhura ngushtë, duke e bërë të domosdoshëm një menaxhim të qëndrueshëm që balancon ruajtjen e biodiversitetit me nevojat zhvillimore të komunitetit. Sfida kryesore qëndron në sigurimin e një ekuilibri midis ruajtjes së integritetit ekologjik të parkut, zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm dhe përfshirjes aktive të komuniteteve lokale në këtë proces.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), përmes Grantit të financuar nga PONT në Parkun Kombëtar të Prespës-PKP (PA_024), duke zbatuar Planin Operacional 2025 të dakordësuar për këtë zonë të mbrojtur, është e angazhuar për këtë qëllim dhe si rrjedhim kërkon për një ekspert që do të hartojë një dokument strategjik mbi Integrimin e Aspekteve Socio-Ekonomike në Menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës-PKP.

2. Objektivat

Objektivat kryesore të angazhimit të ekspertit janë si më poshtë:

- a. Të hartojë një dokument strategjik mbi Integrimin e Aspekteve Socio-Ekonomike në Menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës-PKP.
- b. Ky dokument do të ofrojë udhëzime praktike për Administratën e Zonave të Mbrojtura (AdZM) Korçë dhe do të shërbejë si bazë për politika dhe masa menaxheriale, që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve vendore në përputhje me objektivat e ruajtjes së biodiversitetit të Parkut Kombëtar të Prespës-PKP.

3. Detyrat dhe Përgjegjësitë

Fokusi i detyrës do të jetë Parku Kombëtar i Prespës-PKP sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për krijimin e një Raporti strategjik mbi Integrimin e Aspekteve Socio-Ekonomike në Menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës-PKP” për AdZM Korçë lidhur me PKP. Eksperti do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme për raportin që do të hartojë:

- *Analizë të situatës aktuale:* Vlerësimi i faktorëve socialë dhe ekonomikë, që ndikojnë në menaxhimin e parkut (PKP), duke përfshirë aktivitetet ekonomike ekzistuese, modelet e përdorimit të tokës dhe sfidat e komuniteteve lokale.
- *Identifikim të zonave me potencial për zhvillim të qëndrueshëm:* Vlerësimi i mundësive për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, bujqësisë ekologjike dhe iniciativave të tjera ekonomike që nuk dëmtojnë ekosistemin dhe identifikim i zonave me potencial në PKP për këtë qëllim.

- *Përcaktim të strategjive për përfshirjen e komuniteteve lokale:* Propozimi i mekanizmave për të integruar komunitetet në menaxhimin e parkut (PKP), duke përfshirë trajnime, partneritete dhe mbështetje për nisma të qëndrueshme ekonomike.
- *Hartim të masave për ruajtjen e biodiversitetit dhe mbrojtjen e ekosistemeve:* Rekomandime për minimizimin e ndikimit të aktiviteteve ekonomike në habitatet natyrore të parkut (PKP).
- *Zhvillim të politikave për turizmin e qëndrueshëm:* Identifikimi i praktikave më të mira për menaxhimin e fluksit të vizitorëve, përmirësimin e infrastrukturës dhe promovimin e turizmit miqësor ndaj mjedisit në PKP.
- *Rekomandime për institucionet dhe komunitetet lokale:* Propozime për bashkëpunim ndërinstitucional dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve mbi rëndësinë e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në park (PKP).
- *Produkti final (Raporti strategjik) sipas objektit të procedurës duhet të dorëzohet në format pdf dhe word, në mënyrë elektronike dhe fizikisht brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 5.*

4. Kualifikimet dhe Eksperienca

Ekspteri duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Diplomë universitare në zhvillim të qëndrueshëm, shkenca mjedisore, menaxhim të burimeve natyrore dhe kulturore ose fusha të ngjashme.
- Eksperienca të paktën 5-vjeçare në menaxhimin e zonave të mbrojtura, zhvillimin rural ose turizmin e qëndrueshëm.
- Njohuri mbi praktikën më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e biosferave dhe zhvillimin e integruar të komuniteteve.
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe përgatitje të dokumenteve strategjike dhe teknike.
- Aftësi të mira komunikimi dhe përvojë në punën me komunitetet lokale dhe institucionet publike.

5. Kohëzgjatja e konsulencës dhe dorëzimi i Produktit

Shërbimi i konsulencës fillon me nënshkrimin e kontratës respektive me ekspertin e shpallur fitues dhe do të përfundojë me dorëzimin e produktit final **brenda 7 (shtatë) javësh nga nënshkrimi i kontratës**, sipas objektit të procedurës shërbim konsulence “Ekspert për Integrimin e Aspekteve Socio-Ekonomike në Menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës-PKP” për AdZM Korçë lidhur me PKP.

6. Buxheti

Buxheti për kryerjen e procedurës së prokurimit shërbim konsulence i referohet zbatimit të linjave të buxhetit të përcaktuara në Planin Operacional 2025 të grantit të financuar nga PONT për PKP, saktësisht:

- Aktiviteti Nr. 3.1 me objekt "Ekspert për Integrimin e Aspekteve Socio-Ekonomike në Menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës-PKP" për AdZM Korçë lidhur me PKP,

parashikuar në vlerën maksimale 3,250 (tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro, ku përfshihet me tvsh ose 15% tatim në burim.

7. Mënyra e Aplikimit dhe afati

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre me:

- CV-në e detajuar dhe
- Ofertën financiare sipas buxhetit të përcaktuar në planin operacional 2025 sipas pikës 6 më sipër

në adresën zyrtare të emailit: info@akzm.gov.al

Afati për aplikim është deri më datë **23 prill 2025** (përfshirë).